



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 451/7 prot.

Tiranë, më 03.12.2021

VENDIM
Nr.152, datë 03.12.2021

**PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 137, DATË 09.11.2021, NË
INSTITUCIONIN MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraparak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 137, dt. 09.11.2021, “Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2019”, ku shprehimisht është kërkuar: “Të intensifikojë procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve pas përfundimit të afatit të paralajmërimit për rregullimin e ligjshmërisë për institucionet që kanë nëpunës të cilët kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 2347/1 prot., datë 28.05.2021, institucioni ka raportuar për aparatin e ministrisë dhe institucionet e varësisë për punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, vendimin paralajmërues me Nr. 137, dt. 09.11.2021, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr.6395/1 prot., datë 18.11.2021, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrtur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësit:

*****, në pozicionin e punës *“Specialist në Drejtorinë e Auditimit”*;
*****, në pozicionin e punës *“Specialist, Sektori i Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve për Arsimin e Lartë”*, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

2. Pozicionet respektive të punës janë shpallur pozicione të lira, për t’u plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 137, dt. 09.11.2021, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Të njoftohet për këtë vendim, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha